



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Internacional Group Base" Sh.P.K. të datës 20.10.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 17.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-4576-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Internacional Group Base" Sh.P.K. e datës 20.10.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 17.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-4576-2-1-1 ashtu që **ANULOHE**T njoftimi mbi vendimin i datës 17.10.2023 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Internacional Group Base" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Internacional Group Base" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 20.10.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 17.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-4576-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Faqe 1 nga 3

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi nr. 1 - *“Lidhur me pretendimit tuaj ku keni cekur se nuk kemi dorëzuar certifikatat e lëmisë së trajnimit të zjarrëfikësive dhe jo të pastrimit Sa për dijeni kërkes e DT është : 4. Operatori Ekonomik duhet te posedoj minimumin (5) punëtor(staff) te certifikuar për siguri dhe shëndet ne pune ne përputhshmëri me Ligjin Nr.04 L-161 sipas organogramit te kompanisë. 4. Te dëshmohet me kopje te certifikatave valide dhe organogrami te kompanisë (kopje). Ne si GOE kemi bashkangjitur dy raporte të vlerësimit të rrishtit ku Brenda raporteve ceket se janë të trajnuar për siguri dhe shëndet në punë dhe si kulafikim ekstra kanë edhe atë për zjarrëfikës. DËSHMI keni Çertifikatat e sigurisë dhe shëndetit në punë si dhe atë për zjarrëfikës që nuk është shkelje ligjore. Po ashtu në faqen nr 3 të raportit të vlerësimit të riskut tek OE SKIFTERAT LIVE në listen e pozitive është edhe fusha e trajnimit për PUNËTOR PASTRIMI. PO ashtu edhe vetë INTERNACIONAL GROUP BASE ka të këryer vlerësimin dhe trajnimin për punëtorët e saj ku si dëshmi keni edhe raportin e bashkangjitur me ofertë. Ku në fq. 2 ceket se kemi trajnuar 8 punëtor”.*

Pretendimi nr. 2 - *“Në pretendimin tuaj ju keni sekur se nuk kemi dorëzuar ISO 14001-2018 por kemi dorëzuar 14001 – 2015. Ne lidhur me këtë pretendim tuajin jemi të habitur se cili nga OE pjesëmarrës ka mundur ta ketë këtë iso kur jemi në dijeni të gjithë se 14001 – 2015 është vresioni I fundit dhe jemi të bindur se anjë nga OE pjesëmarrëse nuk ka dorzuar IOS 14001-2018. Për të dëshmuar një gjë të tillë ne kemi kërkuar edhe nga Agjensia Kosovare e Standartizimit ku kemi pyetur lidhur me këtë ISO STANDART dhe kemi marrë këtë përgjigjeje: PYETJA I nderuar Ju drejtohem me këtë shkres se a mund të na informoni se cili është vresioni i fundit i ISO STANDARTIT 14001 i njohur në vendin tonë?Faleminderit për mirëkuptim.Me respect PËRGJIGJËJA Të nderuar, Standardi EN ISO 14001:2015 (SK EN ISO 14001:2018) Sistemet e menaxhimit të mjedisit - Kërkesat me udhëzim për përdorimin e tij -/- Environmental management systems - Requirements ëith guidance for use, është standardi i fundit në fuqi. Si standard EN ISO, standardi i fundit në fuqi është EN ISO 14001:2015, të cilin AKS e ka adoptuar më vonë dhe si i tillë është SK EN ISO 14001:2018 (d.m.th EN ISO 14001:2015 është ekuivalent me SK EN ISO 14001:2018 Pra duke u bazuar në atë që dëshmuam pretendimi juaj është I pa bazuar pasi që edhe vetë Insitucioni gjegjës e konfirmon një gjë të tillë”.*

Pretendimi nr. 3 - *“Sa i përket “PALNIT DINAMIK” nuk e kuptojm ku ka qenë kjo kërkes nese keni menduar për kërkesen tuaj lidhur me planin për shpeshësin e pastrimit kërkesa nr 8 e juaj. Këtë planë e gjeni në ofertën tonë fjali me nr 2 I emruar DEKLARATAT dhe në faqen nr 4”.*

Pretendimi nr. 4 - *“Për më tepër ne pas qasjes kemi parë se OE I rekomanduar në kontratë ka ofruar një analizë kompletë kundërshtim me kërkesat tuaja për arsye se: OE schafberger nuk e ka bere llogaritjen si duhet per punen gjat vikendeve dhe festave duke I kalkuluar vetem 3 punetor, ku minimumi per mbulimin e ketyre pikave duhet te ju llogaritur shtesa 30 te punesurve. Kalkolimi I OE-se schafberger ne vlere prej 6940.08 per 3 vite eshte I gabuar duke pasur nje diferenc ne cmim, 71,181.81-7,363.64=64,241.74 euro diferenca”.*

Lidhur me pretendimin nr. 1 dhe 3 fillimisht duhet theksuar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar nuk është specifikuar se për cilën kërkesë të dosjes së tenderit bëhet fjala saktësisht. Si shembull, si arsye për eliminimin e parashtruesit është evidentuar “keni dorëzuar certifikatat e kualifikimit të lëmisë së zjarrëfikësive dhe jo të pastrimit” mirëpo nuk është saktësuar se cila ka qenë saktë kërkesa e dosjes së tenderit për të cilën po bëhet fjalë (për cilat certifikata është fjala).

Lidhur me pretendimin nr. 2 është gjetur se komisioni vlerësues në raportin e vlerësimit nuk ka kërkuar/ofruar sqarime lidhur me ekuivalencën eventuale ndërmjet ISO EN 14001:2018 dhe IS EN 14001:2015. Duke marrë parasysh pretendimin ankimor atëherë komisioni përkatës me rastin e rivlerësimit duhet të kërkoj sqarimet e nevojshme lidhur me këtë kërkesë të dosjes së tenderit sipas nenit 59 paragrafit 2 të LPP. Varësisht nga sqarimet e ofruara, komisioni duhet të veproj në përputhje me parimin për trajtimin e barabartë të gjithë tenderuesve në kuptim të nenit 7 të LPP.

Lidhur me pretendimin nr. 4 duhet theksuar se ky pretendim i referohet ofertës së tenderuesit të rekomanduar nga komisioni vlerësues dhe jo letrës standarde për eliminimin e parashtruesit. Duke qenë se parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit (edhe përtej arsyeve të evidentuara në pretendimet e tij ankimore) atëherë parashtruesi në raport me këtë pretendim të tij nuk është palë e interesuar në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP ku përcaktohet se "Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar". Në rastin konkret parashtruesi nuk mund të dëshmojë interes material në raport me ofertat e tenderuesve të tjerë përderisa vet është i papërgjegjshëm. Sidoqoftë me rastin e rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit do të shqyrtohen të gjitha ofertat nga fillimi prandaj detyrë e komisionit është po ashtu shqyrtimi i këtij pretendimi të parashtruesit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij nr. 2 dhe vetëm pjesërisht pretendimin nr. 1 dhe nr. 3. Ndërsa nuk ka arritur që të parashtrtoj argumente apo dëshmi sa i përket pretendimit nr. 4. Në këtë mënyrë është gjetur se komisioni vlerësues nuk pra vepruar në përputhje me nenin 59 të LPP dhe 40 të RRPP. Për këto arsye është miratuar si e bazuar pjesërisht kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 30.10.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Faqe 3 nga 3